

1. Këndi i rënies së rrezeve të Diellit në Tokë në orën 12.00 është më i madh, ndërsa në orën 14.00 është më i vogël.

a) Në ç'orë temperaturat e ajrit në Tokë janë më të mëdha?

**1 pikë**

**Përgjigje:**

Temperatura e ajrit në Tokë është më e lartë në orën 14.00 dhe jo në orën 12.00, pavarësisht se këndi i rënies së rrezeve të Diellit është më i madh në orën 12.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse përcakton se temperatura e ajrit është më e lartë në orën 14.00**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

b) Argumentoni përgjigjen tuaj.

**2 pikë**

Kjo ndodh pasi temperaturat e ajrit në Tokë ngrohen më tepër nga rrezatimi tokësor, sesa nga rrezatimi diellor. Deri në orën 12.00 toka merr vazhdimisht nxehtësi nga dielli, dhe më pas e lëshon nxehtësinë në ajër. Për këtë arsye, temperatura e ajrit është më e lartë në orën 14.00 sesa në orën 12.00.

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë nëse bën shpjegimin e saktë**

**1 pikë nëse bën shpjegimin e pjesshëm**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**

2. Vëzhgoni me kujdes hartën.

a) Shpërndarjen e cilave dukurive natyrore tregon kjo hartë?

**1 pikë**

Harta tregon shpërndarjen e tërmeteve dhe vullkaneve

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse shkruan tërmetet dhe vullkanet**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

b) Shkruani katër zonat/brezat ku kjo dukuri është më e përhapur.

**4 pikë**

- Brezi ose zona e Paqësorit (unaza e Zjarrtë e Paqësorit) ku ndodhin 80% e tyre
- Brezi i Mesdheut
- Brezi i Afrikës Lindore
- Mesoret oqeanike (të oqeanit Atlantik, Paqësor dhe Indian).

**Nxënësi fiton:**


**4 pikë nëse shkruan të katërta zonat**

**3 pikë nëse shkruan tre nga zonat**

**2 pikë nëse shkruan dy nga zonat**

**1 pikë nëse shkruan një nga zonat**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**



c) Pse kjo dukuri është përqendruar pikërisht në këto zona.

**2 pikë**

**Përgjigje:**

Sepse në ato zona pllakat tektonike ndahen mes tyre me sisteme çarjesh. Në buzët e pllakave tektonike zhvillohet i gjithë aktiviteti tektonik (lindin tërmetet, formohen vullkanet, malet etj.)

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë nëse shpjegon saktë sa më sipër**

**1 pikë nëse shkruan sistemet e çarjeve OSE aktivitetin tektonik në buzët e pllakave**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

3. Lëvizjet e pllakave tektonike formojnë tipa të ndryshëm kufijsh midis tyre.

- a) Përcaktoni llojin e kufijve në figurën 1 dhe figurën 2. **2 pikë**

**Përgjigje:**

Figura 1: - kufij divergjentë


Figura 2: - kufij konvergjentë

**Nxënësi fiton:**

**2 pikë nëse përcakton të dy tipet e kufijve**

**1 pikë nëse përcakton njërin prej tyre**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**



- b) Shpjegoni se çfarë ndodh në figurën 1. **3 pikë**

**Përgjigje:**

Figura 1 tregon kur dy pllaka largohen nga njëra – tjetra. Gjatë largimit nga njëra – tjetra të të dyja pllakave, krijohet mes tyre një e çarë e thellë e quajtur rift. Në të çarën e krijuar, del në sipërfaqe të tokës, magma që vjen nga astenosfera. Kjo magmë depozitohet në të dyja anët e riftit dhe formon në oqeanë koren mesoqeanike

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse për shpjegimin e saktë sa më sipër**

**2 pikë nëse shkruan se pllakat largohen nga njëra tjetra, gjatë largimi krijohet një e çarë dhe se nga e çara del magma**

**1 pikë nëse shkruan se pllakat largohen nga njëra - tjetra**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

- c) Formimin e cilës pjese të rruzullit tokësor shpjegon kjo teori. **1 pikë**

Shpjegojnë se si janë formuar oqeanet.

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse shkruan se janë formuar oqeanet.**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

4. Sa është koha lokale e Ankarasë me gjatësi gjeografike lindore  $33^{\circ}$ , kur në Tiranë me gjatësi gjeografike lindore  $20^{\circ}$ , koha lokale është  $13h05'$ . **4 pikë**

Gjejmë sa është ndryshimi i gjatësisë midis gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës.

$$33^{\circ} - 20^{\circ} = 13^{\circ}$$

$$24 \text{ h} \longrightarrow 360^{\circ}$$

$$1 \text{ h} \longrightarrow 15'$$

$$X = 360 * 1 / 24 = 15^{\circ}$$

Toka për 1 orë ( $60'$ ) rrotullohet  $15^{\circ}$ , gjejmë sa minuta i duhen asaj për që të rrotullohet  $1^{\circ}$ .

$$60 \text{ min} \longrightarrow 15^{\circ}$$

$$X \text{ min} \longrightarrow 1^{\circ}$$

$$X = 60 * 1 / 15 = 4 \text{ minuta}$$

Për 4min Toka rrotullohet  $1^{\circ}$ , gjejmë sa minuta i duhen asaj që të rrotullohet  $13^{\circ}$ .

Kështu:

$$\text{Për } 4 \text{ min} \longrightarrow 1^{\circ}$$

$$\text{Për } X \text{ min} \longrightarrow 13^{\circ}$$

$$X = 13 * 4 / 1 = 52 \text{ min}$$

Pra ndryshimi midis kohës lokale të Ankarasë dhe Tiranës është 52min.

Koha lokale e Ankarasë është  $13h05' + 52' = 13h57'$

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë** nëse bën një zgjidhje të plotë të ushtrimit.

**OSE**

**3 pikë** nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës; gjen se për sa minuta rrotullohet Toka për  $1^0$  dhe gjen në minuta ndryshimin në grade të gjatësisë gjeografike midis Ankarasë dhe Tiranës

**2 pikë** nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës, gjen se për sa minuta rrotullohet Toka për  $1^0$

**1 pikë** nëse gjen ndryshimin midis gjatësisë gjeografike të Ankarasë dhe Tiranës.

**0 pikë** nëse e zgjidh gabim ose nuk e zgjidh fare

5. Ndërtoni profilin topografik të vijës së hequr AB në hartën topografike të dhënë.

**3 pikë**


**3 pikë** nëse ndërton profilin e saktë

**2 pikë** Nëse ndërton pingulet (projeksionet) dhe kodrën e parë

**1 pikë** Nëse ndërton profilin e kodrës së parë **OSE** ndërton vetëm pingulet (projeksionet)

**0 pikë** Nëse e ndërton profilin gabim ose nuk e ndërton fare

*Shënim: nëse nxënësi e ndërton profilin pa hequr pingulet nuk fiton asnjë pikë.*



6. A është e mundur që një vend të jetë pjesë e disa rajoneve? Argumentoni përgjigjen tuaj nëpërmjet një shembulli konkret.

**3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Po, mund të jetë, pasi rajonet përcaktohen në mënyra të ndryshme; kjo varet nga qëllimi dhe objekti i rajonizimit. P.sh.

a) Pakistani është pjesë e rajonit fizik të Azisë Jugore

b) Është pjesë e rajonit të botës islame

c) Për nga zhvillimi ekonomik i përket Botës së Tretë

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë** nëse pohon që është e mundur dhe nëse jep 3 këndvështrime të rajonizimit të një vendi.

**2 pikë** nëse pohon dhe jep 2 këndvështrime të rajonizimit të një vendi

**1 pikë** nëse pohon dhe jep 1 këndvështrim të rajonizimit të një vendi

**0 pikë** nëse thjesht pohon pa dhënë argument **OSE** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare

7. Shpjegoni dallimin midis rajoneve funksionalë dhe atyre jofunksionalë, nëpërmjet shembujve konkretë.

**3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

Një kriter i rëndësishëm për klasifikimin e rajoneve është ndërthurja e elementeve fizikë dhe atyre humane. P.sh. Antarktida është një kontinent për nga madhësia, por nuk përfaqëson një rajon funksional, ndërkohë që Amerika e Jugut p.sh. është një rajon gjeografik funksional, sepse ka të mishëruar tërësinë e faktorëve fizikë dhe humanë.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse shpjegon kriterin bazë të klasikimit të këtyre rajoneve dhe jep shembujt përkatës për të dy tipet e rajoneve**

**2 pikë nëse shpjegon kriterin bazë dhe njërin nga tipat e rajoneve**

**1 pikë nëse shpjegon vetëm kriterin bazë të klasikimit të këtyre rajoneve**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

**8.** Shpjegoni tri nga përparësitë gjeografikë të rajonit të Evropës.

**3 pikë**

**Model përgjigjeje:**

- Vendndodhja e saj në qendër të hemisferave tokësore mundëson lidhje ekonomike me pjesët e tjera të botës.
- Vija e gjatë bregdetare dhe portet kanë mundësuar lidhjet detare me vendet fqinjë, si edhe kanë ndihmuar në zbulimet e mëdha gjeografike.
- Lumenjtë e shumtë përbëjnë një rrjet të dendur të rrugëve të brendshme ujore.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse shkruan tre nga përparësitë**

**2 pikë nëse shkruan dy nga përparësitë**

**1 pikë nëse shkruan një nga përparësitë**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**

**9.** Zhvillimi gjeologjik i trevave shqiptare vazhdon ende.

- Shkruani dëshmitë që vërtetojnë këtë fakt nëpërmjet shembujve konkret.

**3 pikë**

- Lëvizjet diferencuese të sotme me karakter ulës (fushëgropa e Korçës, Përrenjasit, gropa e liqenit të Ohrit, Butrinitit etj)
- Lëvizjet diferencuese të sotme me karakter ngritës (pjesa më e madhe e territorit)
- Lëvizjet sizmike në zonat e thyerjeve aktive tektonike Lezhe – Shkodër – Ulqin; Vlorë – Lushnje – Elbasan etj.

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse shkruan tre nga dëshmitë së bashku me shembujt konkretë**

**2 pikë nëse shkruan dy nga dëshmitë së bashku me shembujt konkretë**

**1 pikë nëse shkruan një nga dëshmitë së bashku me shembujt konkretë**

**0 pikë nëse shkruan llojin e lëvizjeve pa dhënë shembujt konkretë OSE**

**Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare**

**10.** Pas vitit 1990, ekonomia bujqësore në Rajonin Perëndimor (ashtu si kudo në gjithë Shqipërinë) pësoi ndryshime të mëdha si rrjedhojë e ndryshimeve që ndodhën në Shqipëri. Identifikoni tre nga këto ndryshime.

**3 pikë**

- U prish struktura e mëparshme, toka iu nda fshatarëve
- Ndryshoi struktura e prodhimeve bujqësore në varësi të kërkesave që ka tregu.
- U rritën të ardhurat e popullsisë fshatare

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse identifikon tre nga ndryshimet**

**2 pikë nëse identifikon dy nga ndryshimet**

**1 pikë nëse identifikon një nga ndryshimet**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

**11.** Krahasoni veçoritë e detit dhe bregdetit Jon me atë Adriatik . Shkruani të paktën tre ndryshime midis tyre. **4 pikë**

*Një ndryshim midis **detit** Adriatik e Jon:*

a) \_\_\_\_\_

*Tre ndryshime midis **bregdetit** Adriatik e Jon:*

a) \_\_\_\_\_

b) \_\_\_\_\_

**Përgjigje:**

**Detet:**

Kripësia e detit Jon është më e lartë se e Adriatikut

Tejdukshmëria e detit Jon është më e lartë se e Adriatikut

Thellësia e detit Jon është më e madhe se e Adriatikut

**Bregdetet:**

Bregdeti i Jonit është zallor ndërsa ai i Adriatikut në pjesën më të madhe është ranor

Në bregdetin e Jonit mbizotëron gërryerja ndërsa në atë të Adriatikut grumbullimi

Në bregdetin e Jonit deti përparon drejt bregut, ndërsa në atë të Adriatikut në pjesën më të madhe bregu përparon drejt detit

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë nëse jep një nga ndryshimet mes detit dhe tre nga ndryshimet mes bregdetit**

**3 pikë nëse jep një nga ndryshimet mes detit dhe dy nga ndryshimet mes bregdetit**

**2 pikë nëse jep një nga ndryshimet mes detit dhe një nga ndryshimet mes bregdetit**

**1 pikë nëse jep një nga ndryshimet mes detit OSE një nga ndryshimet mes bregdetit**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

**12.** Zona e Alpeve Shqiptare dallohet për një botë bimore dhe shtazore tepër të pasur. Madje është zona ku rriten më shumë bimë endemike.

a) Evidentoni faktorët që kanë kushtëzuar këtë larmi të botës së gjallë. **3 pikë**

Përgjigje:

- Relievi tepër i thyer
- Mozaiku i theksuar i kushteve klimatike
- Larmia e madhe e tokave

**Nxënësi fiton:**

**3 pikë nëse evidenton tre nga faktorët**

**2 pikë nëse evidenton dy nga faktorët**

**1 pikë nëse evidenton një nga faktorët**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

**13.** Gropat dhe fushëgropat përbëjnë një nga format e relievit në territoret shqiptare.

a) Ku ndryshon morfologjia e gropave nga ajo e fushëgropave? **1 pikë**

**Përgjigje:**

Gropat kanë një reliev më të coptuar krahasuar me fushëgropat, pasi këto të fundit kanë një reliev më të sheshtë

**Nxënësi fiton:**

**1 pikë nëse shkruan përgjigjen e mësipërme**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**

b) Shpjegoni pse morfologjia e tyre është e ndryshme.

**4 pikë**

**Përgjigje:**

Gropat kanë relief më të thyer, ndërsa fushëgropat kanë relief më të sheshtë.

Relievi i tyre është i ndryshëm sepse gropat përfshihen nga lëvizje ngritëse. Në këtë mënyrë lumenjtë thellojnë shtretërit e tyre dhe relievi është më i thyer. Fushëgropat janë përfshirë nga lëvizje ulëse dhe lumenjtë akumulojnë sasi të mëdha materialesh. Për këtë arsye ato kanë një relief më të sheshtë.

**Nxënësi fiton:**

**4 pikë nëse shpjegon saktë sa më sipër (përcakton saktë llojin e lëvizjeve në secilën prej tyre dhe rolin e lumenjve si pasojë e këtyre lëvizjeve)**

**3 pikë nëse shpjegon saktë njërin prej tyre dhe pjesërisht tjetrën**

**2 pikë nëse shpjegon saktë vetëm njërin prej tyre**

**1 pikë nëse shpjegon pjesërisht njërin prej tyre**

**0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare**